T O T A L I	6,380	4,430,415	144	13,158	296

** Shënim.* Vlen të theksohet se koeficienti i kriminalitetit është përlogaritur si rezultat i numrit të përgjithshëm të veprave penale të kryera në një rreth të caktuar gjyqësor përmbi numrin e popullsisë së atij rrethi. Gjithashtu në leximin e kësaj table nuk është llogaritur numri i çështjeve penale të përfunduara të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda që për vitin 2016 është **162** çështje penale, si dhe nuk janë llogaritur çështjet penale ushtarake, pasi kjo tabelë vlen për koeficientin e **kriminalitetit në shkallë vendi**.



KREU V

- ❖ **ÇËSHTJET E GJYKUARA PËR KRIMET E KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**
(Cases tried for crimes of Corruption and Organized Crime)

STATISTIKAT PËR PERSONAT E GJYKUAR DHE DËNUAR PËR VITIN 2016

(Statistics for persons convicted and sentenced for 2016)

Lufta kundër korrupsionit është identifikuar qartazi nga partnerët ndërkombëtarë, por sidomos nga BE-ja, si një nga elementët kyç për përparimin e Shqipërisë drejt integritetit evropian. Në kuadër të prioritetëve të qeverisë, lidhur me politikat anti-korrupsion, gjatë tremujorit të fundit të vitit 2013, janë ndërmarrë një numër masash konkrete për të siguruar llogaridhënie duke dëshmuar vullnetin e fortë për të luftuar fenomenin e korrupsionit në vend.

Gjatë kësaj periudhe është krijuar institucioni i Koordinatorit Kombëtar Anti-korrupsion, si një organ i rëndësishëm në nivel ministror që do të koordinojë masat kundër korrupsionit dhe politikat në nivel kombëtar. Për t'i dhënë një dimension të ri, më të plotë, luftës kundër korrupsionit u miratua paketa antikorrupsion dhe në Kodin e Procedurës Penale, në kompetencën lëndore të Gjykatës së Krimeve të Rënda u shtuan edhe veprat penale të korrupsionit ndaj zyrtarëve të lartë, të gjyqtarëve, prokurorëve etj., ku korrupsioni konsiderohet, si krim i rëndë, jo në kuptim të rritjes së masës së dënimit, por në faktin që këto vepra penale do të luftohen me të njëjtat mjete, siç luftohen organizatat dhe bandat kriminale.

Gjithashtu me ndryshimet e bëra në K.Pr. Penale u harmonizua legjislacioni procedural, në përputhje me ndryshimet kushtetuese, të bëra në vitin 2012, për kufizimin dhe heqjen e imuniteteve të zyrtarëve të lartë, përfshirë dhe gjyqtarët e të gjitha niveleve, pasi kjo reformë në atë kohë, nuk u shoqërua me ndryshimet e nevojshme në Kodin e Procedurës Penale.

Së fundmi, Kuvendi ka miratuar, ligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, datë 20.03.2014, me qëllim shtrirjen e masave parandaluese kundër pasurisë së personave që dyshohen se kanë kryer veprime korruptive. Synimi i këtij ligji është rritja e përpjekjeve për të dekurajuar në maksimum korrupsionin, nëpërmjet sekuestrimit apo konfiskimit të të gjitha pasurive të paligjshme, që burojnë nga veprat penale të korrupsionit. Në nenin 21, paragrafi i tretë i këtij ligji parashikohet se: “Barra e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi”. Në këtë kuptim, vlera reale e këtij ligji qëndron në faktin se, nuk do të jetë prokurori që do të provojë paligjshmërinë e vënies së pasurisë, por do të jetë individ, i cili duhet të provojë të kundërtën përpara gjykatës me prova dhe fakte konkrete sesi e ka vënë pasurinë e sekuestruar dhe konfiskuar edhe në rastet e korrupsionit.

Në kuadër të përmbushjeve të objektivave strategjike gjatë procesit të integritetit, 3 hallkat e sistemit gjyqësor, polici, prokurori dhe gjykata, janë angazhuar maksimalisht në luftën kundër kriminalitetit, me qëllim çmontimin e murit të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Për këtë çështje konsiderohet shumë e rëndësishme, harmonizimi i të dhënave statistikore ndërmjet hallkave të sistemit gjyqësor dhe gjurmimin e rasteve konkrete të veprave penale të mësipërme.

Çështjet e shqyrtuara nga gjykatat për veprat penale të Korrupsionit

(Cases reviewed by the courts for corruption criminal offences)

Nga të dhënat statistikore të mbledhura nga Gjykatat në shkallë Republike, rezulton se **në vitin 2012**, janë gjykuar nga **Gjykatat e Shkallës së Parë 152** persona dhe janë dënuar **122** persona, ndërkohë që nga **Gjykatat e Apelit** janë gjykuar **125** persona dhe janë dënuar **78** persona.

Për vitin 2013, rezulton se janë gjykuar nga **Gjykatat e Shkallës së Parë 221** persona dhe janë dënuar **154** persona, ndërkohë që nga **Gjykatat e Apelit** janë gjykuar **126** persona dhe janë dënuar **100** persona. Në këtë vit, nga Gjykatat në rang Republike, janë gjykuar **347** persona dhe janë dënuar **254** persona.

Nga të dhënat statistikore të mbledhura nga Gjykatat në shkallë Republike, rezulton se **në vitin 2014**, rezulton se janë gjykuar nga **Gjykatat e Shkallës së Parë 242** persona dhe janë dënuar **195** persona, ndërkohë që nga **Gjykatat e Apelit** janë gjykuar **171** persona dhe janë dënuar **103** persona.

Nga analiza e këtyre shifrave konstatohet një trend në rritje si në numrin e personave të gjykuar ashtu edhe në numrin e personave të dënuar nga të dy shkallët e gjyqësorit.

Për vitin 2015, nga ana e ekspertëve të Delegacionit të BE, është bërë ndryshimi i tabelës së matjeve të rritjes së luftës kundër Korrupsionit dhe në vend të personave të gjykuar, është kërkuar numri i personave të shpallur të pafajshëm nga ana e Gjykatave në shkallë vendi për këto vepra penale.

Në këtë vit, rezulton se janë shpallur të pafajshëm nga **Gjykatat e Shkallës së Parë 138** persona dhe janë dënuar **626** persona, ndërkohë që nga **Gjykatat e Apelit** janë shpallur të pafajshëm **115** persona dhe janë dënuar **286** persona.

Për vitin 2016 nga Gjykatat e Shkallës së Parë janë shpallur të pafajshëm 164 persona dhe janë dënuar 701 persona, ndërkohë që nga Gjykatat e Apelit janë shpallur të pafajshëm 143 persona dhe janë dënuar 314 persona.

Krahasimi në përqindje për pesë vitet e fundit për personat e dënuar në lidhje me veprat penale të Korrupsionit, është si më poshtë:

Në vitin 2012 janë dënuar **122** persona në shkallën e parë të gjykimit (një rritje prej **82.6 %** në vitin 2016).

Në vitin 2013 janë dënuar **154** persona në shkallën e parë të gjykimit (një rritje prej **78 %** në vitin 2016).

Në vitin 2014 janë dënuar **195** persona në shkallën e parë të gjykimit (një rritje prej **72 %** në vitin 2016).

Në vitin 2015 janë dënuar **626** persona në shkallën e parë të gjykimit (një rritje prej **11 %** në vitin 2016).

Në shkallën e dytë të gjykimit, rezulton se në vitin 2012 janë dënuar **78** persona (një rritje prej **75 %** në vitin 2016), vitin 2013 janë dënuar **100** persona (një rritje prej **68 %** në vitin 2016), në vitin 2014 janë dënuar **103** persona (një rritje prej **67 %** në vitin 2016), në vitin 2015 janë dënuar **286** persona (një rritje prej **9 %** në vitin 2016) dhe në vitin **2016** janë dënuar **314** persona.

Trendy më i dukshëm i rritjes është pikërisht në të dhënat e dënimit në të dyja shkallët e sistemit gjyqësor.

Nëse i referohemi të dhënave gjatë vitit 2014, për 6-mujorin e parë rezultojnë se në Gjykatat e Shkallës së Parë janë gjykuar **113** persona dhe janë dënuar **96** persona dhe në Gjykatat e Shkallës së Dytë (Apeli), janë gjykuar **89** persona dhe janë dënuar **60** persona. Për 6-mujorin e dytë rezultojnë se në Gjykatat e Shkallës së Parë, janë gjykuar **129** persona dhe janë dënuar **99** persona, në Gjykatat e Shkallës së Dytë (Apeli), janë gjykuar **82** persona dhe janë dënuar **43** persona. Në **total** për gjithë vitin 2014, rezultojnë se në Gjykatat e Shkallës së Parë, janë gjykuar **242** persona dhe janë dënuar **195** persona, në Gjykatat e Shkallës së Dytë (Apeli), janë gjykuar **171** persona dhe janë dënuar **103** persona.

Në vitin 2015, për 6-mujorin e parë rezultojnë se në Gjykatat e Shkallës së Parë janë shpallur të pafajshëm **70** persona dhe janë dënuar **306** persona dhe në Gjykatat e Shkallës së Dytë (Apeli), janë shpallur të pafajshëm **58** persona dhe janë dënuar **135** persona. Për 6-mujorin e dytë rezultojnë se në Gjykatat e Shkallës së Parë, janë shpallur të pafajshëm **68** persona dhe janë dënuar **320** persona, në Gjykatat e Shkallës së Dytë (Apeli), janë shpallur të pafajshëm **57** persona dhe janë dënuar **154** persona. Në **total** për gjithë vitin 2015, rezultojnë se në Gjykatat e Shkallës së Parë, janë gjykuar një numër i madh personash dhe janë dënuar **626** persona, në Gjykatat e Shkallës së Dytë (Apeli), janë një numër i madh personash dhe janë dënuar **286** persona.


Në vitin 2016, për 6-mujorin e parë rezultojnë se në Gjykatat e Shkallës së Parë janë shpallur të pafajshëm **49** persona dhe janë dënuar **392** persona dhe në Gjykatat e Shkallës së Dytë (Apeli), janë shpallur të pafajshëm **74** persona dhe janë dënuar **154** persona. Për 6-mujorin e dytë rezultojnë se në Gjykatat e Shkallës së Parë, janë shpallur të pafajshëm **115** persona dhe janë dënuar **309** persona, në Gjykatat e Shkallës së Dytë (Apeli), janë shpallur të pafajshëm **69** persona dhe janë dënuar **160** persona. Në **total** për gjithë vitin 2016, rezultojnë se në Gjykatat e Shkallës së Parë, janë gjykuar një numër i madh personash dhe janë dënuar **701** persona, në Gjykatat e Shkallës së Dytë (Apeli), janë një numër i madh personash dhe janë dënuar **314** persona.

Nga studimi sasior i këtyre të dhënave, vihet re se nga njëri 6-mujor në tjetrin rezultojnë një trend në rritje pothuajse me 2-fishin e numrit të personave të gjykuar dhe të dënuar.


E njëjta situatë konstatohet edhe në hallkat e tjera të sistemit, në Polici dhe Prokurori, tek të cilat vërehet trendy në rritje e numrit të procedimeve të regjistruara dhe të hetuara për veprat penale të Korrupsionit.

Në grafikët e mëposhtëm, përfshihen dinamikat e numrit të personave të gjykuar dhe të dënuar nga Gjykatat e Shkallës së Parë dhe Gjykatat e Apelit, për veprat penale në lidhje me **Korrupsionin** për vitet 2012, 2013, 2014 si dhe personat e pafajshëm dhe të dënuar për vitin 2015 e 2016.

Gjykatat e Shkallë së Parë, vitet 2012-2016



Gjykatat e Apelit, vitet 2012-2016



Çështjet e shqyrtuara nga gjykatat për veprat penale të Krimit të Organizuar

(Cases reviewed by the courts for criminal offences of organized crime)

Lufta kundër krimit të rëndë e atij të organizuar, përbën tashmë një fazë të rëndësishme të zhvillimit shoqëror të shoqërisë shqiptare e sistemit të drejtësisë në veçanti.

Nga të dhënat statistikore të mbledhura nga gjykatat në vitin 2012, për veprat penale që lidhen me **Krimin e Organizuar**, i janë nënshtruar procesit gjyqësor, në Shkallë të Parë **456** persona, në cilësinë e të pandehurve dhe prej këtyre **430** janë dënuar, ndërkohë që në Gjykatat e Apelit janë gjykuar **466** persona dhe janë dënuar **439** persona.

Në vitin 2013, nga të dhënat statistikore të mbledhura nga gjykata rezulton, për veprat penale që lidhen me **Krimin e Organizuar**, i janë nënshtruar procesit gjyqësor, në Shkallë të Parë **425** persona, në cilësinë e të pandehurve dhe prej këtyre **368** janë dënuar, ndërkohë që në Gjykatat e Apelit janë gjykuar **454** persona dhe janë dënuar **408** persona.

Nga të dhënat statistikore të mbledhura nga gjykata rezulton se në vitin 2014, për veprat penale që lidhen me **Krimin e Organizuar**, i janë nënshtruar procesit gjyqësor, në Shkallë të Parë **550** persona, në cilësinë e të pandehurve dhe prej këtyre **501** janë dënuar, ndërkohë që në Gjykatat e Apelit janë gjykuar **489** persona dhe janë dënuar **460** persona.



Për vitin 2015, nga ana e ekspertëve të Delegacionit të BE, është bërë ndryshimi i tabelës së matjeve të rritjes së luftës kundër Krimit të Organizuar dhe në vend të personave të gjykuar, është kërkuar numri i personave të shpallur të pafajshëm nga ana e Gjykatave në shkallë vendi për këto vepra penale.

Për vitin 2015, rezulton se janë shpallur të pafajshëm nga Gjykatat e Shkallës së Parë **23** persona dhe janë dënuar **547** persona, ndërkohë që nga Gjykatat e Apeleve janë shpallur të pafajshëm **58** persona dhe janë dënuar **654** persona. Nga këto të dhëna konstatohet një trend në rritje të dënimit të personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale të Krimit të Organizuar.

Nga të dhënat statistikore të mbledhura nga gjykatat për **vitin 2016**, rezulton se janë shpallur të pafajshëm nga Gjykatat e Shkallës së Parë **25** persona dhe janë dënuar **557** persona, ndërkohë që nga Gjykatat e Apeleve janë shpallur të pafajshëm **42** persona dhe janë dënuar **508** persona. Nga këto të dhëna konstatohet një trend në rritje të dënimit dhe ulje të pafajshmërisë së personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale të Krimit të Organizuar.

Duke parë shifrat e të dhënave statistikore të këtyre viteve, vëmë re se lufta ndaj Krimit të Organizuar është në vëmendje të organeve të Drejtësisë dhe ka pësuar një rritje në vitet e fundit.

Në vitin 2014 ka patur një rritje të ndjeshme të numrit të personave të gjykuar dhe të dënuar nga Gjykatat e Shkallës së Parë, ndërsa nga Gjykatat e Apelit, rritja e numrit të proceve dhe personave të dënuar, ka pësuar rritje të konsiderueshme në vitin **2015**.



Për vitin 2016 janë **Sekuestruar dhe më pas Konfiskuar** nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda në total Vlerat Monetare dhe asete të tjera si më poshtë:

- Në Euro: **40,400**
- Sipërfaqe truall (tokë arë): **23,328 m²**
- Në Lekë: **35,885**
- Automjete: **12**
- Pasuri me sipërfaqe **82.6 m²**
- Apartament banimi **1**, me sipërfaqe **80.6 m²**

- ☐ Dyqan me sipërfaqe **61 m2**

Ndërkohë janë **Konfiskuar** për periudhën e sipërcituar:

- ☐ Mjeti avion sportiv “PIPER”
- ☐ Kamion tip “Renault”
- ☐ Një autobus “Setra”

Gjithashtu, edhe nga hallkat e tjera të sistemit nga Policia dhe Prokuroria konstatohet një trend në rritje e numrit të rasteve të regjistruara dhe të hetuara nga viti 2014, 2015 në vitin 2016 për veprat penale të Krimin të Organizuar.


Në rastin e gjykimeve dhe dënimeve, vihet re një rënie në vitin 2016 në krahasim me vitin 2015 për veprat penale në lidhje me Krimin e Organizuar.

Të dhënat e grupuara në mënyrën tabelare dhe grafike për Grup-Veprat Penale në lidhje me korrupsionin, krimin e organizuar dhe krimet e rënda në vitin 2016, paraqiten si vijon:


Grup-Veprat Penale në lidhje me korrupsionin, krimin e organizuar dhe krimet e rënda (Criminal offences related to corruption, organized crime and serious crimes)	Gjykatat e Rretheve Gjyqësore (District Court)		Gjykatat e Apelit (Appeal Courts)	
	Numri i personave të shpallur të pafajshëm (No. of people acquitted)	Nr. personave të denuar (No. of convicted persons)	Numri i personave të shpallur të pafajshëm (No. of people acquitted)	Nr. personave të denuar (No. of convicted Persons)
KORRUPSIONI	164	701	143	314
Grupi 1: Korrupsioni në sektorin publik	106	339	98	172
Neni 135	4	74	16	35
Neni 244	5	12	4	14
Neni 244/a	0	0	0	0
Neni 245/1	0	46	0	29
Neni 248	96	179	72	74
Neni 256	0	0	1	0
Neni 258	0	6	1	3
Neni 259	1	22	4	17
Neni 259/a	0	0	0	0
Grupi 2: Konflikti i interesave dhe deklarimi i pasurisë	1	14	4	3
Neni 257	0	3	0	0
Neni 257/a	1	11	4	3
Grupi 3: Korrupsioni i nivelit të lartë	0	1	4	2
Neni 245	0	1	4	1
Neni 260	0	0	0	1
Grupi 4: Korrupsioni në Sistemin Gjyqësor	0	11	1	5
Neni 312	0	0	0	4
Neni 319	0	5	0	0
Neni 319/a	0	0	0	0
Neni 319/b	0	0	0	0
Neni 319/c	0	0	1	1
Neni 319/ç	0	6	0	0
Neni 319/d	0	0	0	0
Neni 319/dh	0	0	0	0

Neni 319/e	0	0	0	0
Grupi 5: Korrupsioni në sektorin privat	0	1	0	0
Neni 164	0	1	0	0
Neni 164/a	0	0	0	0
Grupi 5: Falsifikimi	57	335	36	132
Neni 186	49	144	33	78
Neni 186/a	0	1	1	3
Neni 189	3	88	0	27
Neni 190	5	102	2	24
KRIMI I ORGANIZUAR DHE KRIMET E RENDA	25	557	42	508
Grupi 1: Trafikimi i qënieve njerëzore	0	63	0	18
Neni 109	0	0	0	4
Neni 109/b	0	48	0	12
Neni 110/a	0	10	0	0
Neni 128/b	0	5	0	2
Grupi 2: Trafikimi i veprave të artit, kulturës dhe mjeteve motorike	2	11	0	0
Neni 138/a	0	1	0	0
Neni 141/a	2	10	0	0
Grupi 3: Kontrabanda	0	1	0	1
Neni 175	0	1	0	1
Neni 176	0	0	0	0
Grupi 4: Falsifikimi i parave	1	36	2	17
Neni 183	1	36	2	17
Neni 184	0	0	0	0
Grupi 5: Trafikimi i armëve	1	1	8	71
Neni 278/a	1	1	8	71
Neni 282/a	0	0	0	0
Grupi 6: Trafikimi i lëndëve narkotike	15	391	23	360
Neni 283	12	293	16	233
Neni 283/a	3	87	6	113
Neni 284/a	0	2	0	0
Neni 284/c	0	9	1	14
Neni 284/ç	0	0	0	0
Grupi 7: Pastrimi i parave	3	34	9	16
Neni 287	1	8	4	4
Neni 287/b	2	26	5	12
Grupi 8: Terrorizmi	2	9	0	9
Neni 111	0	0	0	0
Neni 230	1	0	0	0
Neni 230/a	0	0	0	0
Neni 230/b	0	0	0	0
Neni 230/c	0	0	0	0
Neni 230/ç	0	0	0	0
Neni 230/d	0	0	0	9
Neni 231	0	9	0	0
Neni 232	0	0	0	0
Neni 232/a	1	0	0	0
Neni 232/b	0	0	0	0
Neni 233	0	0	0	0
Neni 234	0	0	0	0
Neni 234/a	0	0	0	0
Neni 234/b	0	0	0	0
Grupi 9: Vepra penale të Krimit të Organizuar	1	11	0	16
Neni 333	0	0	0	0
Neni 333/a	1	11	0	16
Neni 334	0	0	0	0
TOTALI	189	1,258	185	822

Në grafikun e mëposhtëm, përfshihen dinamikat e numrit të personave të gjykuar, të dënuar dhe të pafajshëm nga **Gjykatat e Shkallës së Parë**, për veprat penale në lidhje me Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në total) për vitet 2012, 2013, 2014, 2015, si dhe vitin 2016.



Në grafikun e mëposhtëm, përfshihen dinamikat e numrit të personave të gjykuar, të dënuar dhe të pafajshëm nga **Gjykatat e Apelit**, për veprat penale në lidhje me Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në total) për vitet 2012, 2013, 2014, 2015 si dhe vitin 2016.



KREU VI



- ❖ **ÇËSH TJET E GJYKUARA PËR KRIMET NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË SIPAS KODIT PENAL USHTARAK**
(Cases tried for crimes by the first instance courts according to the Military Criminal Cod)

**ÇËSHTJET E REGJISTRUARA PËR KRIMET NË GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË
SIPAS KODIT PENAL USHTARAK**
(Cases tried for crimes in the first instance courts according to
the military criminal code)

Neni (Article)	Figura e Veprës Penale (Criminal act)	Çështje (Criminal cases)
33	Dezertimi (Desertion)	6
36/2	Mosparaqitja në repart ose në vendin e shërbimit (Non-apperance at military unit or service post)	1
55	Vjedhje armatimi (Armed theft's)	1
57	Vjedhja e municionit (Theft of ammunition)	1
59	Vjedhja (Theft)	4
T O T A L I		13

ÇËSHTJET E REGJISTRUARA PËR KUNDËRVAJTJE USHTARAKE (Cases tried for military contraventions)

Neni (Article)	Figura e Veprës Penale (Criminal act)	Çështje (Criminal cases)
35/1	Largimi pa leje (Unanthorized leave)	1
36/1	Mosparaqitje në repart ose vendin e shërbimit (Non-appearance in the military unit or service post)	10
37/1	Mosparaqitja e oficerëve ose nënoficerëve aktivë (Non-appearance of active officers or non-commissioned officers)	10
53/1	Kundërshtimi i policisë ushtarake (Opposition of the military police)	1
72	Pranimi i favoreve nga ushtaraku (Admission of favors by military officer)	1
95	Mbajtja pa të drejtë e shenjave të shërbimit shëndetësor në ushtri (Unauthorized use of military service marks in the army)	1
96	Shpërdorimi i shenjave të shërbimit shëndetësor (Abuse of health service mark's)	1
T O T A L I		25

MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE PENALE USHTARAKE ME VENDIME GJYQËSORE PËRFUNDIMTARE (Way of settlement of military criminal cases by final court decisions)

☐ Me vendim fajësie	29
☐ Me vendim pafajësie	1
☐ Vendosur pushimi i çështjes	0
☐ Vendosur kthimi për plotësim hetimesh	0
☐ Vendosur moskompetenca	0
	30

PARAQITJA ANALITIKE E TË DHËNAVE STATISTIKORE TË ÇËSHTJEVE PENALE USHTARAKE (Analytical presentation of statistical data on military criminal cases)

Dinamika dhe mënyra e përfundimit për vitin 2016 paraqitet si vijon:

- ☐ Çështje të mbartura **14** (8 Krime ushtarake, 6 Kundërvajtje)
- ☐ Ardhur gjatë vitit **24** (5 Krime, 19 Kundërvajtje)
- ☐ Ardhur pas prishjes **0** çështje (0 Krime, 0 Kundërvajtje)
- ☐ Gjithsej për gjykim **38** (13 Krime, 25 Kundërvajtje)
- ☐ Kanë përfunduar së gjykuari **30** çështje (11 Krime, 19 Kundërvajtje) ku është dhënë :
- ☐ Fajësi për **29** çështje
- ☐ Pafajësi për 1 çështje
- ☐ Pushim vendimi për 0 çështje
- ☐ Kthim për plotësim hetimesh **0** çështje
- ☐ Moskompetencë **0** çështje
- ☐ Kanë mbetur pa përfunduar **8** çështje (2 Krime, 6 Kundërvajtje).

SHPEJTËSIA E GJYKIMIT (Term of trial)

Në periudhën deri 2 muaj është përfunduar gjykimi i **4** çështjeve (0 krime + 4 kundërvajtje penale ushtarake).

Në periudhën nga 2 - 6 muaj është përfunduar gjykimi i **18** çështjeve (4 krime + 14 kundërvajtje penale ushtarake).

Në periudhën nga 6 muaj - 1 vit është përfunduar gjykimi i **8** çështje (7 krime + 1 kundërvajtje penale ushtarake).

Për periudhën mbi 1 vit është përfunduar gjykimi i **0** çështje penale ushtarake (0 krime dhe 0 kundërvajtje penale ushtarake).

Të dhënat e grupuara në mënyrën tabelare paraqiten si vijon:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District Court)	Deri 2 muaj (up to 2 months)	2 - 6 Muaj (2-6 months)	6 muaj - 1 vit (6 months-1 year)	Mbi 1 vit (Over 1 year)
K R I M E				
Berat	-	-	-	-
Durrës	-	-	3	-
Elbasan	-	-	-	-
Shkodër	-	-	-	-
Tiranë	-	2	1	-
Vlorë	-	2	3	-
TOTALI	0	4	7	0


Gjykata e Rrethit Gjyqësor (District Court)	Deri 2 muaj (up to 2 months)	2 - 6 muaj (2-6 months)	6 muaj - 1 vit (6 months-1 year)	Mbi 1 vit (Over 1 year)
K U N D Ë R V A J T J E				
Berat	-	-	-	-
Durrës	-	-	-	-
Elbasan	-	-	-	-
Shkodër	-	-	-	-
Tiranë	4	12	-	-
Vlorë	0	2	1	-
TOTALI	4	14	1	0

Për 30 çështjet ushtarake të përfunduara **13.3 %** e tyre kanë një afat shqyrtimi deri 2 muaj, **60 %** në periudhën 2-6 muaj dhe **26.7%** kanë përfunduar me afat shqyrtimi 6 muaj – 1 vit.

ÇËSHJTJET USHTARAKE (Military cases)

Çështjet penale ushtarake (Military criminal cases)	Përfunduar (Terminated cases)	Papërfunduar (Pending)	TOTALI
Viti (year) 2012	32	14	46
Viti (year) 2013	11	21	32
Viti (year) 2014	30	7	37
Viti (year) 2015	16	14	30
Viti (year) 2016	30	8	38

Çështjet penale ushtarake 2012 - 2016



ANKIMIMET (Complaints)

Në vitin 2016 për të gjitha çështjet e përfunduara, nuk është apeluar **asnjë** çështje si tek krimet, ashtu edhe për kundërvajtjet.

DËNIMET (Sentences)

Në gjykatën e rrethit **Tiranë** janë regjistruar **23** çështje penale ushtarake gjithsej për vitin 2016 nga të cilat: **19** çështje kanë përfunduar dhe **4** çështje nuk kanë përfunduar.

Në gjykatën e rrethit **Tiranë** janë gjykuar 19 persona dhe janë dhënë 5 dënime me burgim, 14 dënime me gjobë.

Në gjykatën e rrethit **Vlorë** janë regjistruar gjithsej **9** çështje penale ushtarake, prej të cilave **8** kanë përfunduar dhe **1** çështje është papërfunduar. Për **7** çështje është dhënë fajësi dhe për **1** çështje është dhënë pafajësi.

Janë gjykuar gjithsej **8** persona, ku për **7** është dhënë fajësi. Nga **7** të dënuar, **3** persona janë dënuar me gjobë dhe **4** persona janë dënuar me burgim deri në 2 vjet.

Në gjykatën e rrethit **Durrës** janë regjistruar gjithsej **3** çështje penale ushtarake dhe të gjitha kanë përfunduar me vendim fajësie, çështje të papërfunduara nuk ka. Në gjykatën e rrethit **Durrës** janë gjykuar **3** persona. Dhe për këta **3** të dënuar është dhënë dënimi me burgim deri në 2 vjet.

Në gjykatën e rrethit **Berat** janë regjistruar **3** çështje penale ushtarake të cilat nuk kanë përfunduar.

Numri i të dënuarve nga gjykata e rrethit **Berat** është **3** persona është dhënë dënimi me burgim deri në 2 vjet.

Në gjykatën e rrethit **Shkodër** nuk janë regjistruar çështje penale ushtarake dhe për rrjedhojë në këtë gjykatë nuk ka patur persona të gjykuar dhe të dënuar.

Gjithashtu edhe në gjykatën e rrethit **Elbasan** nuk ka patur për vitin 2016 çështje penale ushtarake dhe persona të dënuar për vepra penale ushtarake.

Në shkallë vendi janë gjykuar **34** persona, ku janë dënuar **32** persona.

Nga **32** persona ndaj të cilëve është dhënë vendim fajësie, kemi panoramën si vijon:

- ☐ Me gjobë, **20** persona
- ☐ Burgim deri 2 vjet, **10** persona
- ☐ Burgim 2 deri 5 vjet, **1** person
- ☐ Burgim 5 deri 10 vjet, **0** persona
- ☐ Burgim 10 deri 25 vjet, **1** person

Krahasime të çështjeve ushtarake të gjykuara me katër vite më parë (Comparisons to tried four years ago of military cases)

Krahasuar me vitet 2013, 2014 dhe me vitin 2015 çështjet penale ushtarake të regjistruara dhe të gjykuara në vitin 2016 në volum reflektojnë rritje të tyre, duke përjashtuar vitin 2012 i cili ka patur një volum më të madh çështje të regjistruara. Në vitin 2016 rritja e çështjeve penale ushtarake është më e theksuar se në vitet 2013 e 2015. Konkretisht: në masën 8 çështje të regjistruara më pak krahasuar me vitin 2012 dhe 2 çështje të shqyrtuara më pak. Në masën 6 çështje më shumë të regjistruara dhe 19 çështje të shqyrtuara më shumë krahasuar me vitin 2013, në masën 1 çështje më shumë të regjistruar dhe 0 çështje të shqyrtuara më shumë krahasuar me vitin 2014 dhe në masën 8 çështje më shumë të regjistruara dhe 14 çështje të shqyrtuara më shumë krahasuar me vitin 2015.

Lidhur me **modën** e veprave penale ushtarake të gjykuara gjatë këtyre viteve të fundit kemi **klasë modale krimet penale për vitet 2012, 2013**, për vitin 2016 kemi klasë modale **kundërvajtjet sikundër edhe në vitin 2014 e 2015**.

24 krime dhe 8 kundërvajtje = **32** çështje të shqyrtuara në vitin **2012**, ku për këtë vit kemi klasë modale krimet.

8 krime dhe 3 kundërvajtje = **11** çështje të shqyrtuara në vitin **2013** (ku kemi klasë modale krimet).

7 krime dhe 23 kundërvajtjet = **30** çështje të shqyrtuara në vitin **2014** (ku kemi klasë modale kundërvajtjet).

4 krime dhe 12 kundërvajtje = **16** çështje të shqyrtuara në vitin **2015** (ku kemi klasë modale kundërvajtjet).

Për vitin 2016 kemi 11 krime dhe 19 kundërvajtje = **30** çështje të shqyrtuara. Pra edhe për këtë vit kemi klasë modale kundërvajtjet.

Vërehet se gjatë vitit 2012 krimet zënë 75% në tërësinë e çështjeve penale ushtarake. Në vitin 2013 krimet zënë 47% në tërësinë e çështjeve penale ushtarake, duke patur një ulje të krimeve në raport me tërësinë e veprave penale ushtarake. Në vitin 2014 krimet zënë **22%** në tërësinë e çështjeve penale ushtarake, duke patur një ulje të krimeve në raport me tërësinë e veprave penale ushtarake. Në vitin 2015 krimet zënë 40% në tërësinë e çështjeve penale ushtarake, duke patur një ulje të krimeve në raport me tërësinë e veprave penale ushtarake.

Në vitin 2016 **krimet** zënë një përqindje më të ulët se **kundërvajtjet** në tërësinë e çështjeve penale ushtarake (të regjistruara). Konkretisht **34.2 %** të tyre.

Si rezultat i luhatjes së çështjeve penale ushtarake të gjykuara dhe strukturës së tyre gjatë 5 viteve të fundit edhe numri i personave të gjykuar për konsumimin e këtyre veprave është me luhatje në vite të ndryshme. Kështu p.sh. **30** persona të gjykuar dhe **25** të dënuar për vitin 2012. Në vitin 2013 kemi një rritje në numrin e personave të dënuar në raport me personat e gjykuar në krahasim me vitet paraardhëse, ku për këtë vit, kemi **11** persona të gjykuar dhe **12** persona të dënuar. **38** persona të gjykuar dhe **18** persona të dënuar për vitin 2014 që pasqyrojnë luhatje të vogla të numrit të të dënuarve për vepra penale ushtarake. Në vitin 2015, kemi **16** persona të gjykuar dhe **14** persona të dënuar.

Në vitin 2016 kemi **34** persona të gjykuar dhe **32** persona të dënuar. Në këtë vit, kemi një ulje të vogël në numrin e personave të dënuar në raport me personat e gjykuar që pasqyrojnë luhatje të vogla të numrit të të dënuarve për vepra penale ushtarake, në krahasim me vitet paraardhëse.

Për të dënuarit për këto vepra penale **moda për vitin 2016 është të dënuarit me gjobë**.

KREU VII

❖ KRIMINALITETI PËR TË MITURIT

(Juvenile delinquency)

KRIMINALITETI (TË MITURIT)

(Juvenile delinquency)

Të dhënat statistikore për kriminalitetin e të miturit, krahasuar me vitet 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016 pasqyrojnë një luhajtje të theksuar të fenomenit me ulje dhe ngritje të numrit të dënimeve të dënuar për vepra penale.


Të dënuar të mitur gjatë vitit 2016 janë **562**, nga të cilët **343** të dënuar për krime dhe **219** të dënuar për kundërvajtje penale.

Nga kjo kategori të dënuarish, në vitin 2010 ishin **656** (594 për krime, 62 për kundërvajtje), në vitin 2011 ishin **683** (610 për krime, 73 për kundërvajtje), në vitin 2012 ishin **883** (826 për krime, 57 për kundërvajtje penale), në vitin 2013 ishin 680 (**589** të dënuar për krime dhe **91** të dënuar për kundërvajtje penale), në vitin 2014 ishin 773 (545 për krime dhe 228 për kundërvajtje) dhe në vitin 2015 ishin 601 (410 për krime dhe 191 për kundërvajtje).

Veçori është se edhe për këtë vit, 62% e të dënuarve të mitur janë për krime. E parë nga ana tabelare mund të thuhet se në vitin 2016 në krahasim me vitin 2015, numri i të dënuarve për kundërvajtje ka pësuar një ulje prej 39 të dënuarish. Gjithashtu nga statistikatat e raportuara nga gjykatat **konkludohet se numri i të dënuarve për krime ka pësuar ulje (nga 68% në vitin 2015 në 63% në vitin 2016).** Përsa i përket kundërvajtjeve penale krahasuar po me këtë vit, numri i të dënuarve është në rritje. Duke u krahasuar me të dënuarët në shkallë vendi (**14,614**), të dënuarët e mitur janë **4%** e tyre.

Në mënyrë grafike dhe tabelare, krahasimet lidhur me të dënuarët e mitur në shtatë vitet e fundit jepen si vijon:

Të dënuar të mitur (Juvenile Delinquency)	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
Për krime (Criminal offenses)	594	610	826	589	545	410	343
Për kundërvajtje (Contraventions)	62	73	57	91	228	191	219
Totali	656	683	883	680	773	601	562



TË DËNUARIT TË MITUR, VEPRATË PENALE PËR TË CILËN DËNOHEN DHE MASA E DËNIMIT
(Juvenile convicts, criminal offences for which they are sentenced and the sentence term)

Neni (Article)	Dënuar (Convicts)	Të pafajshëm (Not guilty)	Të pushuar (Ceased)	Pa arsim (Un education)	Me arsim (With education)	Me gjobë (Fine)	Deri 2 vjet (up to 2 years)	2-5 vjet (2-5 years)	5-10 vjet (5-10 years)	10-25 vjet (10-25 years)
76	3	0	0	0	3	0	2	1	0	0
83	1	0	0	0	1	0	1	3	0	0
88	7	0	0	2	5	0	0	1	0	0
108	2	0	0	0	2	0	0	0	1	0
108/a2	1	0	0	1	0	0	2	0	0	0
109/b	12	0	0	0	12	0	2	1	0	0
110/2	1	0	0	0	1	0	4	0	0	0
130/a	12	0	0	0	12	1	0	0	0	0
134/1	92	1	0	38	55	0	2	1	0	0
134/2	125	1	0	66	60	0	0	1	0	0
134/3	1	0	0	0	1	1	0	0	0	0
137/2	3	0	0	1	2	0	1	1	0	0
139	4	0	0	0	4	0	0	1	0	0
140	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0
141	1	0	0	0	1	8	3	0	0	0
143	2	1	0	0	3	1	1	1	0	0
183	3	0	0	0	3	0	0	1	1	0
190	4	0	0	0	4	0	0	10	1	0
236/2	1	0	2	0	3	0	1	0	0	0
237	3	0	0	0	3	0	1	3	1	0
278/1	1	0	0	0	1	0	0	1	0	0
278/2	1	0	0	0	1	0	2	1	0	0
278/4	2	0	0	0	2	0	1	0	0	0
278/6	1	0	0	0	1	0	0	1	0	0
278/a	1	0	0	0	1	4	1	5	0	0
279	11	1	0	0	12	0	1	1	0	0
283	3	0	0	0	3	4	1	0	0	0
283/1	2	0	0	0	2	0	2	0	0	0
283/2	11	0	0	0	11	0	0	2	0	0
284	1	0	1	0	2	0	0	1	0	0
284/1	5	0	0	0	5	0	8	0	0	0
284/2	1	0	0	0	1	0	2	0	0	0
287/b	3	0	0	0	3	0	0	1	0	0
290	1	0	0	0	1	0	4	1	1	0
293/b	1	0	0	0	1	0	0	0	1	0
300	10	0	0	0	10	0	2	0	0	0
301	2	0	0	0	2	0	1	0	0	0
305	5	0	0	0	5	0	0	2	0	0
323	2	0	0	0	2	0	1	0	0	0
Shuma	343	4	3	108	242	19	47	41	6	0

KUNDËRVAJTJET PENALE										
Neni (Article)	Dënuar (Convicts)	Të pafajshëm (Not guilty)	Të pushuar (Ceased)	Pa arsim (Un education)	Me arsim (With education)	Me gjobë (Fine)	Deri 2 vjet (up to 2 years)	2-5 vjet (2-5 years)	5-10 vjet (5-10 years)	10-25 vjet (10-25 years)
84	3	0	0	0	3	1	1	1	0	0
89	11	0	0	0	11	7	3	1	0	0
90	1	0	0	1	0	1	0	0	0	0
112	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0
137/1	3	0	0	0	3	0	1	2	0	0
236/1	1	0	0	0	1	1	0	0	0	0
236/2	1	0	0	0	1	0	0	1	0	0
242	1	0	0	0	1	0	0	1	0	0
273	2	0	0	0	2	1	1	0	0	0
274	2	0	0	0	2	2	0	0	0	0
277	2	0	0	0	2	0	2	0	0	0
278/3	11	0	0	1	10	0	2	8	1	0
291	160	0	1	19	142	23	105	32	0	0
297	19	0	0	10	9	14	4	1	0	0
306/1	1	0	0	0	1	0	1	0	0	0
Shuma Kv	219	0	1	31	189	50	121	47	1	0

KRIME TË KRYERA NGA FEMRAT DHE NUMRI I TË DËNUARAVE

(Crimes committed by females and the number of convicts)

Neni (Article)	Të dënuara (Female convicts)	Neni (Article)	Të dënuara (Female convicts)
76	1	191/2,3	2
79/c	2	199/a1	20
88	2	199/a2	2
96	1	235/2	6
109/b	6	236/2	3
110/a4	1	237	3
113	32	244	1
114	14	245	1
115	3	245/1	17
121/a	3	248	40
124	6	257/a2	1
124/b	8	278/1	1
128/b3	1	278/2	2
130/a	35	278/4	1
134/1	60	279	1
134/2	20	283	2
134/3	1	283/1	6
135	16	283/2	4
137/2	31	283/a2	2
143	20	284	1
144	2	284/1	4
145	98	284/2	2
146	1	287	1
150	6	287/b	1
151	1	290	4
159/1	1	290/1	4
161	2	290/2	3
165	1	290/3	2
172	1	300	1
174	2	301	5
177	2	305	22
178	7	319	1
183	3	324	1
186	31	326	1
187	3	333/a	3
189	11	Te Tjera	2
190	11	SHUMA KRIME	619

Neni (Article)	Të dënuara (Female convicts)	Neni (Article)	Të dënuara (Female convicts)
84	4	199	5
89	19	199/a	4
90	26	200	2
90/1	1	235/1	8
110/1	1	236/1	4
112	4	242	2
119	12	257/a1	2
120	5	272	2
121	3	273	6
125	1	274	3
126	1	275	5
127	10	277	12
128	1	278/3	1
130	8	287/b	1
130/a	5	291	23
137/1	130	297	9
149	2	305/b1	8
170/a	3	306/1	3
180	18	321	1
191/1	1	SHUMA KV	357
197	1		

KOMENTE MBI TË DËNUARAT FEMRA

(Convention on the female convicts)

Numri i të dënuarave femra, krahasuar me të dënuarit në përgjithësi, është në shifra të ulëta, me **976** të dënuara ose **6%** e numrit të përgjithshëm të të dënuarave.


Krahasuar me të dënuarat femra të vitit 2015, kemi një rritje të dënuarash nga kjo kategori shoqërore me **95** të dënuara më shumë, **575** të dënuara më shumë se në vitin 2014, me **366** të dënuara më shumë se në vitin 2013, me **613** të dënuara më shumë se në vitin 2012, me **475** të dënuara më shumë se në vitin 2011 dhe me **427** të dënuara më shumë se në vitin 2010.

Nga 976 femra të dënuara gjatë vitit 2016, për **krime** janë dënuar **619** dhe për **kundërvajtje penale** **357**, pra **63%** e të dënuarave janë për krime dhe **37%** për kundërvajtje penale. Në krahasim me vitin 2015 numri i femrave që kanë kryer krime është rritur nga **60%** të dënuara për krime në vitin 2015, në **68%** të dënuara për krime në vitin 2016.

Në mënyrë tabelare dhe grafike, të dënuarat femra për shtatë vitet e fundit paraqiten si vijon:

Të dënuara femra (Female convicts)	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
Për krime (For criminal offenses)	336	283	226	206	232	525	619
Për kundërvajtje (For Contraventions)	213	218	137	129	169	356	357
Totali	549	501	363	335	401	881	976

TË DËNUARA FEMRA



KREU VIII

- ❖ **PEZULLIMI I EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT ME BURGIM,
SHËRBIMI I PROVËS, ALTERNATIVAT E DËNIMIT ME
BURGIM DHE MBIKËQYRJA ELEKTRONIKE**
(Suspension of sentence enforcement, probation service,
imprisonment alternative sentences and electronic monitoring)

SHËRBIMI I PROVËS, ALTERNATIVAT E DËNIMIT ME BURGIM DHE MBIKËQYRJA ELEKTRONIKE

(Probation Service, imprisonment alternative sentences and electronic monitoring)

Privimi i lirisë në vendet e përparuara të Europës, për një sërë veprash me rrezikshmëri të vogël shoqërore vlerësohet si sanksion i alternativës së fundit dhe si rrjedhojë zbatohet atëherë kur rrezikshmëria e veprës penale të kryer do të bënte të pamundur vendosjen e ndonjë mase tjetër alternative. Në mënyrë të vecantë, vendet e Europës Perëndimore përpiqen të kufizojnë sa të jetë e mundur burgimin duke tentuar drejt formave zëvendësuese të një trajtimi jo-shtrëngues. Kjo bazohet në premisën se burgimi përveçse jep efekte negative tek shkelësit e ligjit ka dhe një kosto financiare shumë të lartë për shoqërinë.

Si pjesë e reformës në sistemin e drejtësisë, me Ligjin nr. 10 024, datë 27.11.2008, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar kuadrin normativo-ligjor për ngritjen dhe funksionimin e institucionit të Shërbimit të Provës si organ shtetëror i specializuar për mbikëqyrjen e dënimeve alternative ndaj burgimit.

Që me krijimin e Shërbimit të Provës vazhdon me intesitet procesi i aplikimit të dënimeve alternative dhe treguesit numerikë janë pozitivë.

Misioni parësor është mbrojtja e komunitetit dhe parandalimi i recidivizmit (përsëritjes së veprës penale), asistimi dhe konsultimi për riintegrimin dhe risocializimin me sukses në komunitet të shkelësve të ligjit duke ndihmuar, nëpërmjet metodave dhe instrumenteve më bashkëkohore, në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin shoqëror dhe sjelljen e ndryshimeve pozitive në jetën e tyre.

Qëllimi i Shërbimit të Provës në Shqipëri është mbikëqyrja dhe mbështetja e:

- ☐ Zbatimit të dënimeve alternative me qëllim mbrojtjen e interesave publike,
- ☐ Parandalimit të kryerjes së veprave penale,
- ☐ Asistimit të personit të dënuar për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga dënimi alternativ,
- ☐ Bashkëpunimit dhe paraqitjes së informacionit dhe raporteve para prokurorisë dhe gjykatës,

Tashmë, Shërbimi i Provës është funksional dhe po bën përpjekje maksimale për rritjen e tij profesionale. Tani më janë të qarta për gjithë stafin se çfarë është Shërbimi i Provës, cili është roli dhe detyra e këtij organi në sistemin e drejtësisë penale, cili është roli dhe misioni i Shërbimit të Provës në Shqipëri, çfarë duhet të bëjë punonjësi i Shërbimit të Provës, cilat janë format e punës, cili është raporti i tij me faktorët e tjerë të drejtësisë penale (gjykatën, prokurorinë, burgjet, policinë e shtetit etj.) apo, cilat janë format e bashkëpunimit të këtij shërbimi me organet e pushtetit qendror, si Policia e Shtetit, etj., me organet e pushtetit vendor, (qarqe, bashki dhe komuna), si dhe me OJF-të etj.

Shërbimi i Provës, punon në komunitet me ata që kanë kryer vepra penale me rrezikshmëri të çdo niveli, kryen të gjitha procedurat ligjore për mbikëqyrjen e të dënuarit në komunitet, në periudhën e provës; i dërgon raport prokurorit për rastet e shkeljeve të kushteve të kohës së provës. Aktualisht Shërbimi i Provës i ka dërguar prokurorit në mjaft raste propozimet përkatëse për shkeljet e kushteve të kohës së provës nga i dënuari dhe për të cilët kane filluar procedurat e kthimit të tij në burg për vuajtjen e kohës së mbetur të dënimit.

Veprimtaria e Shërbimit të Provës

(Probation Service Activity)

Privimi i lirisë në vendet e përparuara të Europës, për një sërë veprash me rrezikshmëri të vogël shoqërore vlerësohet si sanksion i alternativës së fundit dhe si rrjedhojë zbatohet atëherë kur rrezikshmëria e veprës penale të kryer do të bënte të pamundur vendosjen e ndonjë mase tjetër alternative. Në mënyrë të veçantë, vendet e Europës Perëndimore përpiqen të kufizojnë sa të jetë e mundur burgimin duke tentuar drejt formave zëvendësuese të një trajtimi jo-shtrëngues. Kjo bazohet në premisën se burgimi përveçse jep efekte negative tek shkelësit e ligjit ka dhe një kosto financiare shumë të lartë për shoqërinë.

Duke marrë shkas nga përvoja e suksesshme e këtyre vendeve, alternativat e dënimit me burgim janë prezantuar në Kodin Penal të Shqipërisë në vitin 1995, por me rishikimin e vitit 2008 u ndryshuan dhe u përmirësuan përcaktimet në lidhje me to, përmirësime të cilat lejojnë hapësirë më të gjerë për zbatimin në praktikë të tyre, rezultat i të cilës është dhe fillimi i funksionimit të institucionit të Shërbimit të Provës i cili mbikëqyr ekzekutimin e këtyre dënimeve.

Si pjesë e reformës në sistemin e drejtësisë, me Ligjin nr. 10 024, datë 27.11.2008, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar kuadrin normativo-ligjor për ngritjen dhe funksionimin e institucionit të Shërbimit të Provës si organ shtetëror i specializuar për mbikëqyrjen e dënimeve alternative ndaj burgimit.

Vlerat në themel të aktivitetit të Shërbimit të Provës janë, respekti për dinjitetin njerëzor, koncepti i mundësive të individit për të ndryshuar dhe për t'u rritur, si dhe të qenit i drejtë dhe i paanshëm.

Misioni parësor është mbrojtja e komunitetit dhe parandalimi i recidivizmit (përsëritjes së veprës penale), asistimi dhe konsultimi për riintegrimin dhe risocializimin me sukses në komunitet të shkelësve të ligjit duke ndihmuar, nëpërmjet metodave dhe instrumenteve më bashkëkohore, në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin shoqëror dhe sjelljen e ndryshimeve pozitive në jetën e tyre.

Qëllimi i Shërbimit të Provës në Shqipëri është mbikëqyrja dhe mbështetja e:

- ☐ Zbatimit të dënimeve alternative me qëllim mbrojtjen e interesave publike,
- ☐ Parandalimit të kryerjes së veprave penale,
- ☐ Asistimit të personit të dënuar për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga dënimi alternativ,
- ☐ Bashkëpunimit dhe paraqitjes së informacionit dhe raporteve para prokurorisë dhe gjykatës,

Tabela e mëposhtme jep shtrirjen e kompetencave tokësore të rretheve sipas ZVSHP-ve. Këtu me rrethet kemi parasysh ndarjen administrative të territorit të Republikës së Shqipërisë.

Nr	Zyra Vendore	Rrethet administrative
1	Tiranë	Tiranë
2	Shkodër	Shkodër Koplik
3	Kukës	Kukës Has
4	Lezhë	Lezhë Rreshen
5	Mat	Burrel
6	Durrës	Durrës
7	Fier	Fier Ballsh
8	Elbasan	Elbasan Gramsh Peqin Librazhd
9	Berat	Berat Skrapar Kuçovë
10	Korçë	Korçë Bilisht Ersekë
11	Vlorë	Vlorë
12	Gjirokastrë	Gjirokastrë Tepelenë
13	Kavajë	Kavajë
14	Krujë	Krujë
15	Pukë	Pukë
16	Kurbin	Laç
17	Pogradec	Pogradec
18	Përmet	Përmet
19	Sarandë	Sarandë Delvinë
20	Dibër	Dibër Bulqizë
21	Tropojë	Bajram Curri
22	Lushnjë	Lushnjë



Numri total i të dënuarve me dënime alternative që mbikqyren nga Shërbimi i Provës

(Total number of convicts by alternative sentences monitored by the Probation Service)

Për vitin **2016**, numri i të dënuarve me dënime alternative shkoi në **5,577** të dënuar me dënime alternative. Mbikqyrja për secilin prej tyre realizohet mbi bazën e programeve individuale të trajtimit. Nëse nuk do të ishin aplikuar alternativat e dënimit me burgim, sikurse parashikohej në Kodin Penal para ndryshimeve

të bëra me anë të ligjit Nr.10023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, atëherë këta 5,577 persona do të ishin duke vuajtur dënimin me burg, në një nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP).


LLOJI I DËNIMEVE ALTERNATIVE	Viti 2015
Neni 59 i KP, Pezullimi	4460
Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi	74
Neni 64 i KP, Lirimi me kusht	101
Neni 63 i KP, Punë në interes publik	938
Neni 58 i KP, Gjysmëliria	4
TOTALI	5,577

- ☐ Për vitin 2012 janë **2,602** të dënuar me alternativat e dënimit me burgim.
- ☐ Për vitin 2013 janë **2,085** të dënuar me alternativat e dënimit me burgim.
- ☐ Për vitin 2014 janë **4,003** të dënuar me alternativat e dënimit me burgim.
- ☐ Për vitin 2015 janë **5,952** të dënuar me alternativat e dënimit me burgim.
- ☐ Për vitin 2016 janë **5,577** të dënuar me alternativat e dënimit me burgim.

Në mënyrë tabelare dhe grafike sipas llojit të dënimit për vitet 2012, 2013, 2014, 2015 dhe viti 2016 kemi pasqyrën si më poshtë:

LLOJI I DËNIMEVE ALTERNATIVE	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
Neni 59 i KP, Pezullimi	2,166	1,758	3,189	4,798	4,460
Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi	34	36	56	92	74
Neni 64 i KP, Lirimi me kusht	188	146	64	84	101
Neni 63 i KP, Punë në interes publik	214	145	694	974	938
Neni 58 i KP, Gjysmëliria	0	0	0	4	4
TOTALI	2,602	2,085	4,003	5,952	5,577

Në mënyrë grafike sipas llojit të dënimit për vitin 2016 më poshtë :



APLIKIMI I NENIT 59 NË MËNYRË TABELARE ËSHTË SI MË POSHTË:

(Application of article 59 in order table is as follows)

Të dënuar me burg me masën e dënimit **deri në 5 vjet për vitin 2016** si vijon:

	Të dënuar në shkallë vendi (Convicts at national level)		
	Deri në 2 vjet (up to 2 year)	2 – 5 vjet (2-5 year)	TOTALI
Kodi penal (Criminal Code)	10,096	994	11,090
Kodi Penal Ushtarak	10	1	11
TOTALI			11,101

PEZULLIMI I EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT ME BURGIM

(Suspension of imprisonment sentence execution)

Gjykata në rastet kur jep dënim deri në 5 vjet burg në varësi të rrezikshmërisë së pakët shoqërore të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, mund të urdhërojë pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe i dënuari të vihet në provë për një afat nga 18 muaj deri në 5 vjet.

Nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal, siç është parashikuar nga Gjykata, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikqyrjes brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit.

Krahasuar me të dënuarit deri 5 vjet, të pasqyruar në tabelën e mësipërme, **(në total të dënuar)** për të cilët është e mundur të zbatohet Neni 59 i KP, “Pezullimi” rezulton se është pezulluar ekzekutimi i dënimit për **4,460 të dënuar** ose **30.2 %** e të gjithë të dënuarve **deri 5 vjet**.


Krahasuar me katër vitet e fundit pasqyrojmë numrin e të dënuarve që kanë përfituar nga neni 59 i Kodit Penal. Krahasuar me vitin 2015 ku rezultojnë 12,061 persona të dënuar deri në 5 vjet, për 2016 janë **960** raste më pak që përfitojnë nga neni 59. Krahasuar me vitin 2014 ku rezultojnë 8,013 persona të dënuar deri në 5 vjet, janë **3,088** raste më shumë që përfitojnë nga neni 59 për vitin 2016. Krahasuar me vitin 2013 ku rezultojnë 5,701 persona të dënuar deri në 5 vjet, kemi **5,400** raste më shumë të dënuar që përfitojnë nga neni 59 Kodi Penal për vitin 2016. Po të krahasojmë numrin e të dënuarve që kanë përfituar nga neni 59 i Kodit Penal me vitin 2012, në vitin 2016 kemi **5,992** raste më shumë të dënuar që përfitojnë.

Në katër vitet e fundit është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burg përkatësisht për **2,166** të dënuar në vitin 2012, **1,758** të dënuar në vitin 2013, për **3,189** të dënuar për vitin 2014, për **4,798** të dënuar në vitin 2015 dhe për **4,460** të dënuar në vitin 2016. Në përqindje këto shifra janë : **24%** në vitin 2012 ; **21%** në vitin 2013 ; **31%** në vitin 2014, **37.8%** për vitin 2015 dhe **30.2 %** në vitin 2016.

- ☐ **4,460** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59 i KP “pezullim i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë”, shifër kjo e barabartë me **80 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- ☐ **74** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59/a i KP “qëndrim në shtëpi”, shifër kjo e barabartë me **1.3 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- ☐ **101** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 64 i KP “Lirim me kusht”, shifër kjo e barabartë me **1.8 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- ☐ **938** persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 63 i KP “Pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik”, shifër kjo e barabartë me **16.8 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- ☐ **4** persona janë dënuar nga gjykata duke aplikuar nenin 58 të KP “gjysëmliria” shifër kjo e barabartë me **0.1 %** të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.

Sikurse tregojnë shifrat, mbizotëron në masë të madhe nga gjykatat aplikimi i nenit 59 të KP “pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë”, duke bërë të mundur

